

UDHËZIM
Nr. 58, datë 5.12.2014

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 43, DATË 15.10.2014 “PËR
PROCEDURËN E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË DHE TË DYTË, TË OFRUARA NGA
INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË, SI DHE PËR
TRANSFERIMIN E STUDIMEVE NË KËTO INSTITUCIONE PËR VITIN
AKADEMIK 2014 – 2015”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 33, 34 dhe 35 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 3 e udhëzimit nr. 43, datë 15.10.2014, ndryshon si më poshtë:

“3. Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të parë, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, programet e studimit të ciklit të dytë, si dhe për transferimin e studimeve, për vitin akademik 2014-2015, në institucionet private të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, të kryhet deri më datën 12 nëntor 2014, dhe për programet e studimeve të ciklit të dytë, brenda datës 12 dhjetor 2014.”.

2. Pika 5 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

“5. IAL-të private i dërgojnë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP) listën e studentëve të regjistruar në ciklin e parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, brenda datës 17 nëntor 2014, dhe listën e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, brenda datës 15 dhjetor 2014, në formë shkresore dhe elektronike, në format *excel*, në CD. Pas këtyre datave AKP-ja nuk do të pranojë lista shtesë të studentëve për t'u pajisur me numrin e matrikullimit dhe listat e paraqitura nuk do të merren në shqyrtim nga AKP-ja. AKP-ja, respektivisht, brenda datës 17 dhjetor 2014 dhe 15 janar 2014, iu dërgon IAL-ve private listën me numrat e matrikullimit të studentëve. IAL-të private çregjistrojnë studentët e papajisur me numër matrikullimi, si dhe ia komunikojnë çregjistrimin AKP-së, brenda 10 ditëve nga marrja e komunikimit zyrtar nga AKP me listat me numrat e matrikullimit.”.

3. Pika 6 e udhëzimit ndryshon si më poshtë:

“6. IAL-të private, deri në datën 31 dhjetor 2014, për ciklin e parë të studimeve dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe deri në datën 26 janar 2015 për programet e studimeve të ciklit të dytë, dërgojnë zyrtarisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit të dhënat mbi regjistrimet dhe transferimet e studentëve në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë, si dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në formatet e kërkuara sipas udhëzimit nr. 9, datë 25.2.2010 “Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore.”.

4. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, si edhe institucionet private të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla